



PROKURORIA PUBLIKE E KOSOVËS
JAVNO TUŽILAŠTVO KOSOVA

A nr.br.no. 128 /2011

Dt. 30.09.2011
PRISHTINË-PRISTINA

**REPUBLIKA E KOSOVES/
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS / TUŽILAČKI SAVET KOSOVA / KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Në pajtim me nenin 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 4.1.2, neni 14 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr. 03/L-224).

Bazuar në Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, të datës 30 shtator 2011, për aprovimin e këtij Udhëzimi, Kryetari i KPK nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR DORËZIMIN E PROPOZIMEVE
PËR EMËRIMIN E KANDIDATËVE PËR PROKUROR**

Neni 1
Fushëveprimi

Ky Udhëzim rregullon më tej procedurën për dorëzimin e propozimeve për emërim të kandidatëve për prokuror në Zyrën e Presidentit.

Neni 2
Dërgimi i propozimeve për emërim

Siç përcaktohet me Rregulloren mbi procesin e emërimit të prokurorëve, miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, (këndeje e tutje "Këshilli"), Këshilli përcjell propozimet për emërim në Zyrën e Presidentit në përputhje me nenin 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të procesit së ri-shqyrtimit.

Neni 3
Zyrtari kompetent

Drejtori i Përgjithshëm i Prokurorit të Shtetit vepron si zyrtarë kompetent ("zyrtari kompetent"), i cili autorizohet për të dërguar propozimet e Këshillit për emërim në Zyrën e Presidentit. Zyrtari kompetent mban kontakte dhe korrespondencë zyrtare me Zyrën e Presidentit/es lidhur me procesin e emërimeve.

Neni 4
Përmbajta e propozimit për emërim

- 4.1 Përveç propozimit për emërim (shtojca A e këtij Udhëzimi), Këshilli përcjell për në Zyrën e Presidentit biografinë e kandidatit, duke përfshirë këtu por duke mos u kufizuar në datën e lindjes, shtetësinë, arsimin, titujt e nderit dhe përvojën e punës relevante për pozitën. Një model i biografisë është bashkangjitur si shtojcë B në këtë Udhëzim për referencë.
- 4.2 Këshilli mund ti ofroj Zyrës së Presidentit informacione shtesë sipas kërkesës me kusht që informacioni i kërkuar nuk çënon të drejtën kushtetuese të privatësisë.
- 4.3 Neni 6 i këtij Udhëzimi zbatohet përshtatshëmrisht lidhur me afatin kohor mbi ofrimin e informacioneve të kërkuara sipas nenit 4.2 të këtij Udhëzimi.

Neni 5
Ruajta e të dhënave

- 5.1 Të dhënat e përcaktuara me nenin 4 të këtij Udhëzimi vulosen dhe nënshkruhen nga nënshkruesi i autorizuar i Këshillit.
- 5.2 Të dhënat e përcaktuara me nenin 4 të këtij Udhëzimi vendosen në pliko të mbyllur të emërtuar si "konfidenciale" dhe adresohen për "Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës".
- 5.3 Të dhënat e specifikuar në nenin 4 të këtij Udhëzimi ruhen në mënyrë të sigurtë me sistemin mbështetës në rast të humbjes, dëmtimit apo qasjes së pautorizuar të të dhënave.

Neni 6
Pamjaftueshmëria ose paqartësia e të dhënave

Në rast të kërkesës së Zyrës së Presidentit se të dhënat e përcaktuara me nenin 4 të këtij Udhëzimi janë të pamjaftueshme ose të paqarta për ti mundësuar Presidentit të marr një vendim, Këshilli i dorëzon Zyrës së Presidentit të dhënat e kërkuara brenda afatit prej pjesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit.

Neni 7
Procesimi i të dhënave personale

- 7.1 Të dhënat personale të përmbajtura në korrespondencën zyrtare në mes të Këshillit dhe Zyrës së Presidentit, përfshirë këtu të dhënat në nenin 4 të këtij Udhëzimi, do të procesohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 7.2 Të dhënat personale mblidhen vetëm për qëllime të emërimit të prokurorëve dhe nuk do të përpunohen më tej në kundërshtim me qëllimin e grumbullimit të tyre.

Neni 8
Siguria e të dhënave

- 8.1 Këshilli zhvillon procedura për të mbrojtur sigurinë e propozimeve të Këshillit mbi emërimet, përfshirë të dhënat e pranuar sipas nenit 4 të këtij Udhëzimi, të cilat do të jenë të mjaftueshme për të siguruar mbrojtje adekuate për të parandaluar çfarëdo shkatërrimi të paqëllimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, zbulimin, ndryshimin, qasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre.
- 8.2 Procedurat e miratuara sipas nenit 8.1 përfshijnë por nuk kufizohen në një mekanizëm të sigurtë arkivues rezistues ndaj zjarrit.

Neni 9
Konfidencialiteti

- 9.1 Zyrtarët e autorizuar të Këshillit gjatë kryerjes së detyrave në lidhje me përpunimin e të dhënave mbi procesin e emërimit të prokurorëve detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave.
- 9.2 Dështimi për të respektuar konfidencialitetin paraqet shkak për fillimin e procedurës disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi me datën 30.09.2011.

Ismet Kabashi

Kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Nr. XX XX

Datë: XX XX

Në bazë të nenit 84 (18) dhe nenit 110 (2, 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4.1.2 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr. 03/I-224), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), pasi shqyrtoi rekomandimet e Panelit Vlerësues të KPK-së për emërimin e kandidatëve për prokuror, në mbledhjen e mbajtur me datë XX XX 2011, nxori këtë:

V e n d i m


në bazë të cilit Presidentit të Republikës së Kosovës i propozon që z/znj. XXX XXX të emërohet prokuror/e në Prokurorinë XXXXXX në XX për një mandat tre (3) vjeçar.

A r s y e t i m

Në bazë të Rregullores së KPK-së për procesin e emërimit të prokurorëve, KPK përcjell propozimet për emërim në Zyrën e Presidentit në përputhje me nenin 84 (18) dhe 110 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas përfundimit të procesit të ri-shqyrtimit.

Në bazë të rekomandimit të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor dhe Panelit Vlerësues të KPK-së, Presidentit të Republikës së Kosovës i propozohet që z/znj XX XX, të emërohet prokuror/e në Prokurorinë XX në XX për një mandat tre (3) vjeçar.

Vendimit i është bashkangjitur biografia e kandidatit të propozuar.

Jsmet Kabashi

Kryetar i Këshilli Prokurorial

Vendimi i dërgohet:

Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
Drejtorit të Përgjithshëm të PSH-së
Arkivës së Këshillit Prokurorial të Kosovës

Shtojca B

Të dhënat personale
Emri: Numri personal: Data e lindjes: Vendi i lindjes:
Arsimimi
Emri i Institucionit: Diploma apo kualifikimi: Date e diplomimit:
Historia e punësimit
Emri i punëdhënësit: Titulli i punës: Data e fillimit/mbarimit: Detyrat/përgjegjësitë:
Provimi përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë
Institucioni: Data e dhënies: